



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 112, datë 28.06.2024**

**PËR**

**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË EMRIT TË FONDIT TË PENSIONIT VULLNETAR**  
**“SIGAL”**  
**MIRATIMIN E KONTRATAVE TIP INDIVIDUALE TË ANËTARËSIMIT NË FONDIN**  
**E PENSIONIT PRIVAT ME PJESËMARRJE TË HAPUR,**  
**DHE DEKLARATËS TIP TË PRANIMIT TË PJESËMARRJES SË PUNËMARRËSIT**  
**NË FONDIN ME PJESËMARRJE TË HAPUR TË PËRZGJEDHUR NGA**  
**PUNËDHËNËSI**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22 e ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, dhe rregullores nr. 2, datë 31.01.2024 “Për përcaktimin e elementëve të kontratës së anëtarësimit, të deklaratës së pranimit të pjesëmarrjes, të kontratës së administrimit të aktiveve të shoqërisë administruese dhe përmbajtjes e strukturës së prospektit të fondit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e ndryshimit të emrit të Fondit të Pensionit Vullnetar “Sigal”, në “Fond Pensioni Privat me pjesëmarrje të hapur Sigal” dhe miratimin e kontratës tip individuale për anëtarësimin në fondin e pensionit privat me pjesëmarrje të hapur; kontratës tip midis punëdhënësit dhe shoqërisë administruese për anëtarësimin e punëmarrësve të tij në fondin me pjesëmarrje të hapur; deklaratës tip të pranimit të pjesëmarrjes së punëmarrësit në fondin me pjesëmarrje të hapur të përzgjedhur nga punëdhënësi.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**ANËTAR**

**Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Mimoza KAÇI**